



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 24 korrik 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U miratuan disa shtesa dhe ndryshime në kontratën “Për shit - blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH) sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.”.

U miratua një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 139, datë 14.04.2023, “Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë”.

Në kuadër të çështjeve të tjera, u trajtua informacioni mbi planin e masave të gatishmërisë për garantimin e furnizimit me energji elektrike në zonat bregdetare gjatë sezonit veror qershor-shtator 2026 dhe u vlerësuan masat e raportuara nga OSSH sh.a.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.